



**EKR EKSPERTE KONTABËL E REGJISTRUAR
FATMIRA KASTRATI (SYKJA)**

NR LICENCE 14, datë 11/01/2000

RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR

Për auditimin ligjor të fondeve të përfituara dhe të shpenzuara

Partia “Ardhmëria Shqiptare”

Fushata zgjedhore 2015

Periudha 21/05/2015 - 20/06/2015



RAPORTI I EKSPERTIT KONTABËL TË REGJISTRUAR

KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

TIRANË

Të nderuar zotërinj!

Në cilësinë e Ekspertes Kontabël të Regjistruar, bazuar në vendimin numër 969, dt.10.08.2015, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si dhe të kontratës të shërbimit lidhur me të me numër protokollit të saj 7708, datë 29.09.2015, kam audituar pasqyrat që lidhen me financimin e fondeve të përftuara dhe të shpenzuara për fushatën zgjedhore për organet qeverisjes vendore, që fillon me datë 21.05.2015 me regjistrimin e partisë “Ardhmëria Shqiptare” në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (si subjekt zgjedhor) dhe mbyllet me datë 20.06.2015 me përfundimin e fushatës zgjedhore të 21 qershor të vitit 2015.

Përgatitja e këtyre pasqyrave është përgjegjësi e drejtuesve të partisë “Ardhmëria Shqiptare”. Detyra e subjektit zgjedhor është të përgatisë pasqyrat mbi bazën e arkëtimeve dhe pagesave.

Përgjegjësia ime është të shpreh një opinion mbi këto pasqyra bazuar në auditimin e kryer. Auditimi u krye në zbatim të kërkesave të Standarteve Ndërkombetare të Auditimit, në referencë të veçantë me SNA-në 800: “Auditimet e pasqyrave financiare të përgatitura sipas kuadrove për qëllime specifike”.

Këto standarte kërkojnë që unë të planifikoj dhe të kryej auditimin për të zotëruar siguri të arsyeshme se këto pasqyra nuk përmbajnë anomali materiale. Auditimi përfshin shqyrtimin, mbi bazën e testeve, të fakteve që mbështesin shumat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare që përfshijnë: librin e llogarive të subjektit, regjistrin e posaçëm të miratuar si model me vendim nr.266 të KQZ-së, dt.01.06.2009 si dhe pasqyrën e arketim pagesave. Auditimi përfshin gjithashtu, vlerësimin e parimeve të kontabilitetit të ndjekura dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga drejtimi, si edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrës.

Unë çmoj se evidenca e auditimit që kam siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tim të auditimit (forma e opinionit audit: pa opinion).

Partia “Ardhmëria Shqiptare”, ka përfituar fonde publike për fushatën zgjedhore të vitit 2015 në shumën 83,333 lekë, xhiruar në llogarinë bankare të saj

. Sipas deklaratës bashkëngjitur këtij raporti, kjo shumë monetare gjendet në arkën e Partisë. Në pamundësi të sigurimit të evidencës nga Partia “Ardhmëria Shqiptare” për përdorimin e fondeve të përfituara, **nuk mund të shpreh opinionin tim audit. Pa modifikuar opinionin tim , tërheq vëmendjen se Subjekti duhet të tregojë kujdes** në lidhje me vërtetimin dhe pasqyrimin e shpenzimeve të kryera (kur ka) me dokumente justifikues sipas kërkesave të ligjeve fiskale (tatimore), të kërkuar nga ligji “Kodi zgjedhor i RSH” neni 90 , paragrafi 3 i tij. Bashkëlidhur dokumentet përkatëse.

**EKSPERTE KONTABËL E REGJISTRUAR
FATMIRA KASTRATI (SYKJA)**

Tiranë, më 25 nëntor 2015